



Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-14637
Data/Datum 21.07.2023
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 13.07.2023, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës – Ardian Gjini, në tekstin vijues “Komuna”;
2. Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Pëllumb Vula, në tekstin vijues “Ansambli”.

Neni 1
Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët në realizimin e projektit për Koncertin e Vitit të Ri 2024.

Neni 2
Obligimet e Komunës

- 2.1 Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 10,000.00 euro për realizimin e plan projektit nga Ansambli Muzikor i Komunës – Orkestra Simfonike për Koncertin e Vitit të Ri 2024.
- 2.2 Mjetet që do të ndahen për organizimin e koncertit do të ekzekutohen pas pranimi të faturave dhe arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga “Ansambli”.
- 2.3 Mjetet në vlerë prej 10,000.00 euro do të ndahen nga kategoria mallra dhe shërbime e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3
Obligimet e “Ansambilit”

3.1 Obligohet të sjellë faturat origjinale, kontratat-marrëveshjet me instrumentistët, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e saj.

3.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

Neni 4
Realizimi i Koncertit Festiv

Realizimi i plan projektit për koncertet për vitin 2024 nga “Ansambli” fillon me koncertin e Vitit të Ri 2024.

Neni 5

Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga dy ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese.

Neni 6
Hyrja në fuqi


Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë në përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

P A L Ë T

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



Pëllumb Vula

Ansambli Muzikor i Komunës së Gjakovës

